

31995L0018

Direktiva e Këshillit 95/18/KE e 19 qershorit 1995 për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore

Gazeta Zyrtare L 143, 27/06/1995 Fq. 0070-0074

DIREKTIVA E KËSHILLIT 95/18/KE e 19 qershorit 1995 për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 75 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2),

Në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 189 pika (c) të Traktatit (3),

Duke pasur parasysh që tregu i vetëm përbën një zonë pa kufij të brendshëm në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit;

Duke pasur parasysh që parimi i lirisë për ofrimin e shërbimeve duhet të zbatohet për sektorin hekurudhor, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të këtij sektori;

Duke pasur parasysh që Direktiva e Këshillit 91/440/KEE e 29 korrikut 1991 për zhvillimin e hekurudhave të Komunitetit (4) parashikon disa të drejta përdorimi të transportit hekurudhor ndërkombëtar nga ndërmarrjet hekurudhore dhe grupimet ndërkombëtare të ndërmarrjeve hekurudhore;

Me qëllim që të drejtat e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore të zbatohen në të gjithë Komunitetin, në mënyrë të njëjtë dhe jodiskriminuese, nevojitet pajisja me licencë e ndërmarrjeve hekurudhore që ofrojnë shërbimet e përmendura në nenin 10 të Direktivës 91/440/KEE;

Duke respektuar fushën e zbatimit të Direktivës 91/440/KEE, përfshirë edhe përjashtimet e bëra në të për shërbimet rajonale, qytetëse dhe jashtëqytetëse, dhe duke pasur parasysh që edhe aktivitetet e transportit në formën e shërbimeve të linjave vajtje-ardhje përmes Tunelit të Kanalit përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive;

Duke pasur parasysh që për rrjedhojë, një licencë e dhënë nga një Shtet Anëtar duhet të njihet si e vlefshme në të gjithë Komunitetin;

Duke pasur parasysh që kushtet e Komunitetit për mundësi përdorimi ose kalimi përmes infrastrukturës hekurudhore rregullohen nga dispozita të tjera të së drejtës Komunitare;

Duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit, dhe me qëllim sigurimin e njësisimit dhe të transparencës së kërkuar, nevojitet që Komuniteti të përcaktojë parimet e plota të këtij sistemi licencimi, duke u lënë Shteteve Anëtare përgjegjësinë për dhënien dhe administrimin e licencave;

Me qëllim sigurimin e shërbimeve të besueshme dhe të mjaftueshme, është e nevojshme të garantohet që ndërmarrjet hekurudhore të plotësojnë në çdo kohë disa kërkesa në lidhje me emrin e mirë, besueshmërinë financiare dhe aftësinë profesionale;

Duke pasur parasysh që për mbrojtjen e klientëve dhe palëve të treta të interesuara është e rëndësishme të garantohet, që ndërmarrjet hekurudhore të jenë të siguruara në nivel të mjaftueshëm, ose të kenë marrë masa të barazvlefshme në lidhje me rreziqet e përgjegjësisë;

Duke pasur parasysh që pezullimi dhe anulimi i licencave dhe dhënia e licencave të përkohshme, duhet të trajtohen po ashtu në këtë kontekst;

Duke pasur parasysh që një ndërmarrje hekurudhore do t'i kërkohej të veprojë, në përputhje me rregullat kombëtare dhe të Komunitetit, për sigurimin e shërbimeve hekurudhore, të zbatuara në mënyrë jodiskriminuese, të cilat synojnë të sigurojnë që ajo mund të kryejë aktivitetin e vet me siguri të plotë teknike mbi shtrirje specifike të trasesë;

Duke pasur parasysh që të arrihet sigurimi i funksionimit eficient të transportit hekurudhor ndërkombëtar, është e nevojshme që ndërmarrjet hekurudhore të respektojnë marrëveshjet në fuqi në këtë fushë;

Së fundi, duke pasur parasysh që procedurat për dhënien, shfrytëzimin dhe ndryshimin e licencave operuese për ndërmarrjet hekurudhore duhet të reflektojnë një dëshirë të përgjithshme për transparencë dhe mosdiskriminim,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

SEKSIONI I

Neni 1

Qëllimi dhe Fusha e Zbatimit

1. Kjo direktivë përcakton kriteret e zbatueshme për dhënien, rinovimin ose ndryshimin e licencave nga një Shtet Anëtar për ndërmarrjet hekurudhore që janë krijuar ose do të krijohen në Komunitet, kur ato ofrojnë shërbimet e përmendura në nenin 10 të Direktivës 91/440/KEE, sipas kushteve të përcaktuara në atë nen.

2. Ndërmarrjet hekurudhore, aktivitetet e të cilave kufizohen në kryerjen e shërbimeve rajonale, qytetëse ose jashtëqytetëse, përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive.

Ndërmarrjet rajonale dhe grupimet ndërkombëtare aktiviteti i të cilëve kufizohet në dhënien e shërbimeve të linjave vajtje-ardhje që transportojnë mjete rrugore përmes Tunelit të Kanalit, përjashtohen gjithashtu nga fusha e zbatimit të kësaj direktive.

3. Licenca është e vlefshme në të gjithë territorin e Komunitetit.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive:

- (a) “ndërmarrje hekurudhore” nënkupton çdo ndërmarrje private ose shtetërore, aktiviteti kryesor i së cilës është që të ofrojë shërbime transporti hekurudhor për mallrat dhe/ose pasagjerët, me kushtin që ndërmarrja të sigurojë mjete tërheqëse;
- (b) “licencë” nënkupton një autorizim të dhënë nga një Shtet Anëtar një ndërmarrjeje, me anë të së cilit ajo njihet si ndërmarrje hekurudhore. Kjo njohje mund të jetë e kufizuar në ofrimin e llojeve të veçanta të shërbimeve;
- (c) “autoritet licencues” nënkupton organin e ngarkuar nga një Shtet Anëtar për dhënien e licencave.
- (d) “shërbime urbane dhe lokale” nënkuptojnë shërbimet e transportit të kryera për të plotësuar nevojat e transportit të një qendre ose metropoli urban, si dhe nevojat e transportit midis kësaj qendre ose metropoli, dhe zonave përreth;
- (e) “shërbime rajonale” nënkuptojnë shërbimet e transportit të kryera për të plotësuar nevojat për transport të një rajoni.

Neni 3

Çdo Shtet Anëtar cakton një organ përgjegjës për dhënien e licencave, dhe për përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga kjo direktivë.

SEKSIONI II

Neni 4

Licencat

1. Ndërmarrja hekurudhore ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për licencë në Shtetin Anëtar në të cilin është krijuar.

2. Shtetet Anëtare nuk do të japin licenca apo shtyjnë afatin e vlefshmërisë së tyre kur nuk respektohen kërkesat e kësaj direktive.
3. Ndërmarrja hekurudhore që plotëson kërkesat e vendosura në këtë direktivë autorizohet të marrë licencë.
4. Asnjë ndërmarrje hekurudhore nuk lejohet të ofrojë shërbime transporti hekurudhor të rregulluara nga kjo direktivë, nëse nuk i është dhënë licenca përkatëse për shërbimet që do të ofrohen.

Megjithatë, një licencë e tillë nuk i jep mbajtësit të saj të drejtën e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 5

1. Ndërmarrja hekurudhore duhet t'i provojë autoriteteve licencuese të Shtetit Anëtar përkatës, para fillimit të aktiviteteve të saj, se në çdo kohë ajo do të jetë e aftë të plotësojë kërkesat e renditura në nenet 6 deri 9 në lidhje me emrin e mirë, besueshmërinë financiare, aftësinë profesionale dhe mbulimin e përgjegjësive civile.
2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo kërkues paraqet të gjithë informacionin përkatës.

Neni 6

Shtetet Anëtare përcaktojnë kriteret e të provuarit të emrit të mirë për të siguruar që një ndërmarrje hekurudhore kërkuese, ose personat përgjegjës për menaxhimin e saj:

-nuk është/nuk janë dënuar për vepra penale të rënda, përfshirë edhe veprat penale të natyrës tregtare,

-nuk është/nuk kanë shpallur falimentimin,

-nuk është/nuk janë dënuar për vepra penale të rënda kundër legjislacionit specifik të zbatueshëm për transportin,

-nuk është/nuk janë dënuar për mospërbushje të rënda ose të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni social ose i punës, përfshirë edhe detyrimet sipas legjislacionit shëndetësor dhe të sigurisë në vendin e punës.

Neni 7

1. Kërkesat për besueshmërinë financiare konsiderohen të plotësuara kur ndërmarrja hekurudhore kërkuese provon, që është e aftë të plotësojë detyrimet e saj aktuale dhe të mundshme të parashikuara në mënyrë realiste, për një periudhë prej dymbëdhjetë muajsh.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo kërkues provon të paktën kërkesat e detajuara në seksionin I të Shtojcës.

Neni 8

1. Kërkesat në lidhje me aftësinë profesionale konsiderohen të plotësuara kur:
 - (a) Ndërmarrja hekurudhore kërkuese ka ose do të ketë një strukturë menaxhuese që zotëron njohuritë dhe/ose përvojën e nevojshme për të ushtruar kontroll të sigurtë dhe të besueshëm të aktiviteteve të saj, dhe mbikëqyrje të llojeve të aktiviteteve të saj të përcaktuara në licencë.
 - (b) Personeli i saj përgjegjës për sigurinë, në veçanti drejtuesit e automjeteve, janë tërësisht të kualifikuar në fushën e aktivitetit të tyre, dhe;
 - (c) Personeli i saj, mjetet e transportit hekurudhor dhe organizata mund të garantojnë një nivel të lartë sigurie për shërbimet që duhet të ofrohen.
2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo kërkues provon të paktën kërkesat e detajuara në seksionin II të Shtojcës.
3. Për plotësimin e kërkesave të kualifikimit përgatitet një vërtetim me shkrim.

Neni 9

Ndërmarrja hekurudhore sigurohet në formë të përshtatshme, ose merr masa të barasvlefshme për mbulimin, në përputhje me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare, e përgjegjësive të saj në raste aksidentesh, veçanërisht në lidhje me pasagjerët, bagazhin, ngarkesën e mallrave, postën dhe palët e treta.

SEKSIONI III

Neni 10

Vlefshmëria e licencës

1. Licenca është e vlefshme për sa kohë që ndërmarrja hekurudhore përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë direktivë. Megjithatë, autoriteti licencues merr masa për një rivlerësim të rregullt të licencës të paktën çdo pesë vjet.
2. Licenca vetë mund të përmbajë dispozita specifike që rregullojnë pezullimin ose shfuqizimin e saj .

Neni 11

1. Nëse ka dyshime serioze, se një ndërmarrje hekurudhore e licencuar nuk përmbush kërkesat e kësaj direktive dhe në veçanti të nenit 5 të saj, autoriteti licencues mund të kontrollojë në çdo kohë, nëse kjo ndërmarrje hekurudhore në të vërtetë i përmbush këto kërkesa.

Kur një autoritet licencues bindet se ndërmarrja hekurudhore nuk plotëson më kërkesat e direktivës, dhe në veçanti kërkesat e nenit 5 të saj, e pezullon ose e shfuqizon licencën.

2. Kur autoriteti licencues i një Shteti Anëtar ka dyshime të bazuara në lidhje me përmbushjen e kërkesave të caktuara në këtë direktivë nga një ndërmarrje hekurudhore e pajisur me licencë nga autoriteti licencues i një Shteti tjetër Anëtar, i pari informon pa vonesë këtë të fundit.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e paragrafit 1, kur një licencë pezullohet ose shfuqizohet për shkak të mospërmbushjes së kërkesave për besueshmërinë financiare, autoriteti licencues mund të japë një licencë të përkohshme deri në riorganizimin e ndërmarrjes hekurudhore, me kusht që të mos rrezikohet siguria. Licenca e përkohshme është e vlefshme për një periudhë deri në gjashtë muaj pas datës së dhënies së saj.
4. Kur një ndërmarrje hekurudhore ka ndërprerë aktivitetin për gjashtë muaj, ose nuk ka filluar aktivitetin gjashtë muaj pas dhënies së licencës, autoriteti licencues mund të vendosë që licenca të dorëzohet për miratim ose të pezullohet.

Ndërmarrja hekurudhore mund të kërkojë që të vendoset një afat më i gjatë për fillimin e ushtrimit të aktivitetit, duke pasur parasysh natyrën specifike të shërbimeve që ofron.

5. Në rast të ndonjë ndryshimi që prek situatën ligjore të një ndërmarrjeje, dhe veçanërisht në rast të një bashkimi ose blerjeje, autoriteti licencues mund të vendosë që licenca të ridorëzohet për miratim. Ndërmarrja hekurudhore në fjalë mund të vazhdojë ushtrimin e aktivitetit, nëse autoriteti licencues vendos që siguria nuk është rrezikuar; në këtë rast vendimi arsyetohet.
6. Kur ndërmarrja hekurudhore synon të ndryshojë dukshëm ose të zgjerojë aktivitetin e saj, ajo riparaqet licencën e saj për rishikim pranë autoritetit licencues.
7. Autoriteti licencues vendos heqjen e licencës së një ndërmarrjeje hekurudhore ndaj së cilës kanë filluar procedurat e falimentimit ose procedura të ngjashme, nëse bindet se nuk ka perspektivë realiste të ristrukturimit të kënaqshëm financiar brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

8. Kur autoriteti licencues pezullon, shfuqizon ose ndryshon një licencë, Shteti Anëtar përkatës informon menjëherë Komisionin në mënyrën e duhur. Komisioni informon menjëherë Shtetet e tjera Anëtare.

Neni 12

Përveç kërkesave të kësaj direktive, ndërmarrja hekurudhore respekton edhe dispozitat e së drejtës kombëtare miratuar në përputhje me të drejtën Komunitare, dhe zbaton në mënyrë jodiskriminuese, në veçanti:

- kërkesat specifike teknike dhe të ushtrimit të aktivitetit për shërbimet hekurudhore,
- kërkesat e sigurisë që zbatohen për personelin, mjetet e transportit hekurudhor dhe organizimin e brendshëm të ndërmarrjes,
- dispozitat mbi shëndetin, sigurinë, kushtet sociale dhe të drejtat e punëtorëve dhe konsumatorëve.

Neni 13

Ndërmarrja hekurudhore respekton marrëveshjet në fuqi për transportin hekurudhor ndërkombëtar në Shtetet Anëtare në të cilat kryen aktivitetin.

SEKSIONI IV

Neni 14

Dispozitë kalimtare

Ndërmarrjet hekurudhore që kryejnë shërbime hekurudhore kanë një periudhë të përkohshme prej dyvëdhjetë muajsh deri në datën përfundimtare të transpozimit të përmendur në nenin 16 (2), për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e kësaj direktive. Kjo periudhë e përkohshme nuk justifikon asnjë dispozitë që mund të cenonte sigurinë e ushtrimit të aktiviteteve hekurudhore.

SEKSIONI V

Neni 15

Dispozita përfundimtare

1. Procedurat për dhënien e licencave bëhen publike nga Shteti Anëtar përkatës, i cili informon Komisionin në lidhje me to.

2. Autoriteti licencues merr vendim në bazë të gjithë informacionit të disponueshëm për një kërkesë, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tre muaj, pasi i gjithë informacioni përkatës, veçanërisht kërkesat e detajuara të përmendura në Shtojcë, të jenë dorëzuar. Ndërmarrja hekurudhore kërkuese njoftohet për vendimin. Kur kërkesa rrëzohet, jepen arsyet përkatëse.
3. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që vendimet e autoritetit licencues t'i nënshtrohen rishikimit gjyqësor.

Neni 16

1. Dy vjet pas miratimit të kësaj direktive, Komisioni i paraqet Këshillit një raport mbi zbatimin e saj, të shoqëruar nëse është e nevojshme, me propozime mbi veprimet e nevojshme të Komunitetit, veçanërisht mbi mundësinë e zgjerimit të fushës së zbatimit të direktivës.
2. Shtetet Anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme në zbatim të kësaj direktive, brenda dy vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi. Ata informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë.
3. Me miratimin e këtyre dispozitave, Shtetet Anëtare i referohen kësaj direktive ose i shoqërojnë këto dispozita me një referencë në kohën e botimit të tyre zyrtar. Metodatat për të bërë një referencë të tillë përcaktohen nga vetë Shtetet Anëtare.

Neni 17

Direktiva hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 18

Kjo direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 19 qershor 1995.

Për Këshillin

Presidenti

P.PONS

(1) GZ nr. C 24, 28. 1. 1994 dhe GZ nr. C225, 13.8.1994, fq. 9

(2) Mendim i paraqitur më 14 shtator 1994 (GZ nr. C 393, 31.12.1994, fq. 56).

(3) Mendim i Parlamentit European i datës 3 maj 1994 (GZ Nr. C 205, 25.7.1994, fq. 38), Qëndrim i Përbashkët i Këshillit i datës 21 nëntor 1994 (GZ Nr. C 354 i datës 13. 12. 1994, fq. 11) dhe Vendim i Parlamentit European i 14 marsit 1995 (GZ Nr. C 89, 10.4.1995, fq. 30).

(4) GZ nr. L 237, 24.8.1991, fq. 25.

Shtojcë

I. Detajet e përmendura në nenin 7 pika (2).

1. Besueshmëria financiare verifikohet me anë të një llogarie vjetore të ndërmarrjes, ose, në rast të ndërmarrjeve kërkuese që nuk mund të paraqesin llogari vjetore, me anë të një bilanci. Informacione të detajuara mund të jepen veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme:
 - (a) Fondet në dispozicion, duke përfshirë bilancin bankar, overdraftet e siguruara me peng, dhe huatë;
 - (b) Fondet dhe asetet e përdorura si garanci;
 - (c) Kapitalin e punës;
 - (d) Kostot përkatëse, duke përfshirë kostot e blerjes së automjeteve, tokës, ndërtesave, instalimeve dhe mjeteve të transportit hekurudhor;
 - (e) Detyrimet mbi asetet e një ndërmarrjeje.
2. Në veçanti, një kërkues nuk konsiderohet i besueshëm nga pikëpamja financiare, nëse ka detyrime të konsiderueshme të prapambetura të tatimeve ose sigurimeve shoqërore shkaktuar si rezultat i aktivitetit të ndërmarrjes.
3. Autoriteti mund të kërkojë veçanërisht paraqitjen e një raporti kontrolli financiar dhe dokumente të qëndrueshme nga një bankë, bankë shtetërore kursimesh, kontabilist ose kontrolluesi financiar. Këto dokumente duhet të përfshijnë informacionin në lidhje me çështjet e përmendura në paragrafin 1.

II. Detajet e përmendura në nenin 8 pika (2)

1. Detaje mbi natyrën dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit hekurudhor, veçanërisht mbi standardet e sigurisë.
2. Informacion i detajuar të kualifikimeve të personelit përgjegjës për sigurinë dhe të trajnimit të personelit.